

SHOQERIA TREGTARE**“A & S KOMPANI” Sh. p. k.****STATUTI****KREU I****EMERTIMI – OBJEKTI – SELIA – KOHEZGJATJA****NENI 1**

Ne qytetin e Durrës, sot me datën **01 Prill 2021** (dymije e njezete e nje), dite e Enjte, nga ne Ortaket e vetem Themelues shtetasit:

I. Z. Ardian ÇIÇEKU, atesia Shaban, amesia Myzejen, i datelindjes 19/05/1969, shtetas shqipetar, lindur ne Durrës dhe banues ne L.17, Rr.”Prof. Halil Myrto” Durrës, identitet qe verifikohet me Leternjoftimin ID G90519144H.

Kane krijuar Shoqerine Tregtare me Ortaket te vetem dhe me pergjegjesi te kufizuar **“A & S KOMPANI” Shpk** Durrës – Shqiperi.

NENI 2

Shoqeria Tregtare eshte vendase dhe quhet me emrin **“A & S KOMPANI” Shpk** Durrës-Shqiperi emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia Qendrore e Shoqerise **“A & S KOMPANI” Shpk** eshte ne Durrës ne adresen: Lagja. 15, Rruga: Dy Batot, Ish N.B Frutore, Spitalle ,”Nr.Pas 276/18/1, ZK 1574, Durrës – Shqiperi.

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit, ne cdo vend te Komunitetit European.

Me Vendim te Ortakeve te vetem mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja, **normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.**



NENI 5

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **100.000 Lek** (Njëqind mijë) Lek, i formuar dhe nënshkruar nga në Ortaket e vetëm Themeluesit **Z. Ardian ÇIÇEKU** dhe i ndarë në **1 kuotë**, përkatësisht **Z. Ardian ÇIÇEKU** me **1 kuotë**, me vlerë nominative **100.000 lek**

Ortaket e vetëm kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me Kapitalin e saj.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me Letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë, bëhet para kërkesës të drejtuar **Qendres Kombëtare të Biznesit** për njohjen dhe regjistrimin e saj si Person Juridik.

NENI 7

Kohe zgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e regjistrimit Person Juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Me Vendim të Ortakëve të vetëm kohe zgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshoj, dhe ky Vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendres Kombëtare të Biznesit, kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare

NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregëtar në keto Drejtime:

1. Bar, Restorante, Agroturizem, Katering, Hoteleri, Evente, Etj në fushën e turizmit.

2. **Imp-Exp**, Shitje, Blerje, projektim dhe instalime të materialeve elektrike, hidraulike, pajisje të ngrohjes dhe ftohjes, kondicionimi, impjante fotovoltaike, kabina elektrike TU & TM, linja transmetimi TU & TM, nënstacione elektrike, HEC-e, TEC-e, sisteme kamera, sisteme alarmi, etj në fushën e energjisë.

3. **Investim dhe Menaxhim** në fushën e veprimtarisë ndërtimore, për ndërtimin e çdo lloj godine nje ose shumekateshme, Civile, industriale, turistike, bujqësore, qendra biznesi, Hotele, Bar – Restorante, kompletim dhe instalime të nevojshme për to,

4. **Ndërtim dhe mirëmbajtje** për vepra arti të rrugëve të çdo kategorie, përfshirë dhe autostrada veshje me asfaltobeton të rrugëve (ndërtim mbishtrese), sistemim e asfaltim sheshesh, ndërtim pista e aeroporte, ndërtim hekurudhore, ndërtim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtim detare, sikurse janë ndërtimet portuale, basena punime thellimi në porte dhe zgjerim kalatash etj.

5. **Çeljen dhe ushtrimin** e aktivitetit të agjensive imobiliare me qëllim realizimin e shitblerjeve dhe dhenien me qera të pasurive të paluajtshme, me ndodhje në juridiksionin tokësor administrativ të shtetit Shqipëtar, si dhe ushtrimin e aktivitetit koncesionar brenda dhe jashtë vendit, të agjensive turistike dhe Bar-Restoranteve.

6. **Tregtimin me shumicë dhe pakicë** të pajisjeve e materialeve hidrosanitare, elektrike, hidraulike, Rrjeteve kompjuterike, akses kontroll, kamera vëzhgimi, instalimin e tyre nëpër objekte, të ashensorëve, dyerve blindate, të prodhimeve prej duralumini e të pjesëve të ndryshme të

kembimit per çdo makineri apo paisje, si dhe çeljen e reparteve dhe linjave te prodhimit per to, brenda vendit e jashte shtetit, te materialeve te gjithllojshem ndertimore, te teknologjive dhe mjeteve te mekanizuara per nevojat e ndertimit.

7. Çeljen e zyrave te menaxhimit, si per interesat e veta dhe per dhenien e asistences teknike dhe te Supervisionit per instalimet elektrike dhe hidraulike ndaj te treteve.

8. Investim dhe Menaxhim dhe punime dhe kanalizime per rrjetet e jashtme dhe te brendeshme te Ujesjellseve te qendrave te banimit, ne qytet, Komuna dhe fshatra dhe te çdo rrjeti tjeter te sistemit Hidrik, sikurse jane ndertimi dhe kryerja e punimeve permiresuese te Digave, Hidrovoreve, ne Centralet Elektrik, TEC-et, Gabina Elektrike, Nenstacione Elektrike, hapje dhe shtrirje tubacionesh per rjedhjen ne kanalizime te ujrave te bardha dhe te zesa duke shmangur çdo ndotje te Ambientit dhe Mjedisit.

9. Shoqeria te realizoj investime dhe sipermarrje ndertimore per ndertimin e hidrocentraleve dhe TEC-ve, Gabina Elektrike, Nenstacione Elektrike me qellim per te realizuar prodhimin, transmetimin dhe shperndarje te energjise eketrike, si nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj dhe TEC-ve, dhe rehabilitimit te tyre, si vetem dhe duke bashkepunuar me investitore vendas dhe te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese ne fushen e hidro-energjitikes.

10. Marrjen pjese ne Panaire kombetare dhe nderkombetare, qe kane te bejne me çeljen dhe zhvillimin e biznesit, ne fushen e ndertimit dhe te teknologjise bashkekohore te tij, me qellim jo vetem ekspozimin e games se prodhimeve ndertimore te firmes por dhe per te mundesuar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregetar me to, si dhe pjesmarrje ne Tendera brenda e jashte vendit.

NENI 9

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit, per njohjen dhe Rregjistrimin e saj si Person Juridik ne Rregjistrin tregetar te asaj Qendre.

Ushtimin e Aktivitetit tregetar e fillon pasi te jete rregjistruar dhe paisur me **Certifikaten NIPT** nga Qendra Kombetare e Biznesit.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine tregetare ne perputhje me Legjislacionin shqipetar ne fuqi, si ate tregetar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore specifike per ushtimin e saj, sipas objektit te veprimtarise se saj, si dhe mbi bazen e Aktit te Themelimit si dhe Statutin e saj.

KREU II:

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11



Shoqeria çel Llogari Bankare në leke vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaket e vetem dhe Administratori Përgjithshëm i caktuar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria dhe terheqja e pjeseve të saj bëhet kur Çeku bankar është firmosur nga Ortaket e vetem dhe Administratori i Shoqërisë, dhe në rastin kur Ortaket kanë caktuar me shumë se një Administrator, i cili është jashtë ortakërisë, ceku bankar dhe çdo likuidim apo pagesë nënshkruhet nga Ortaket që është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe nga Administratori jashtë Shoqërisë.

NENI 12

Pjesët e Kapitalit Themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket e vetem kanë të drejtë që të transferojnë jashtë territorit të Republikës Shqiptare pjesërisht apo tërësisht Kontributet e saj përfshirë dhe Fondet e Kontributet në natyrë.

Transferimet e pjeseve të Kapitalit Themelor, duhet të jenë të vertetuara me Kontrate Noteriale dhe për një gjë të tillë Ortaket duhet të marrin paraprakisht Vendimin me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese të tij, vetëm në rast se është legalizuar nga një Noter.

Shoqëria dhe të tretet, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 13

Kapitali Themeltar i Shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e Vendimit me shkrim që marrin Ortaket e vetem, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë depozitim të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila dhe e ka regjistruar Shoqërinë Person Juridik.

KREU III:

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE, TE DREJTAT DHE DETYRAT

NENI 14

Ortaket e vetem janë organi më i lartë **Drejtues** dhe **Vendimor** i Shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që Ligji "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i njeh "Asamblese të Ortakëve"

Ortaket mund t'ja delegojnë kompetencat një ose me shumë personave fizik apo juridik, vendas apo të huaj dhe jashtë ortakërisë së Shoqërisë, mbi bazën e **Prokures**, të bërë me akt noterial.

NENI 15

Me Vendim të Ortakëve të vetem, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër tregëtare si brenda vendit dhe jashtë shtetit.

NENI 16

Ortakët e Shoqërisë kanë dhe keto të drejta dhe detyra kryesore:

* Te marrin pjesë në drejtimin dhe administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë ekonomike tregtare të Shoqërisë dhe të çdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj

* Te kërkojnë dhe tu japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe të gjitha dokumentave të përpunuara nga Shoqëria, ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të Bilancit Kontabel apo për çdo llogari të çelur, si të asaj Likuiduese dhe asaj Rrjedhse.

* Te marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë në çfarëdo Forme apo sasi, sipas kontributit të dhënë prej tij.

* Te kryejnë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt ligjore të Shoqërisë.

* Me Vendim, Ortakët e vetëm emerojnë dhe shkarkojnë në çdo kohë Administratorin e Shoqërisë, si dhe Ekspertin Kontabel të autorizuar .

* **Ortakët e vetëm** si kryesisht dhe me anë të Administratorit, ushtrojnë dhe keto Tagra (të Drejta) :

Mundësohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj siç mund të jenë:

1. Te lidhin Kontrata të ndryshme që kanë për objekt Blerjen, shitjen, këmblimin dhe marrjen me qera të Pasurive të ndryshme (te luajtshme dhe të paluajtshme), atë të servitutit, uzufuktit Enfiteozes, Franchising, Sipërmarrje Ndërtimi, etj si me persona fizike dhe me Persona juridike vendas apo të huaj, me shtetin dhe në rastin e blerjes të Pasurive të Paluajtshme apo marrjen e tyre me qera për një kohë më 9 vjet, si dhe të Kontratave të Servitutit, Uzufuktit dhe Enfiteozes, duhet të bëjnë regjistrimin Hipotekat e ZVRPP të rrethit të juridiksionit përkatës si për transkriptimin e Pronësive në favor të Shoqërisë apo kalimin e kësaj pasurie në posedim ligjor.

Cdo blerje e pasurive të mesipërme, konsiderohet dhe si shtesë e Kapitalit në Natyrë.

2. Te kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha Zyrave shtetërore dhe Private, Bankat e çdo niveli etj, që kanë të bëjnë me Garancite, Sipërmarrjet, marrjen e Kredive, të Sigurimeve dhe Risigurimeve për jetën dhe Demet, Transportit (brenda vendit dhe jashtë shtetit) kryerjen e veprimeve doganore për zhdoganimin e mallrave të importuara deklarimin e atyre të eksportuar, plotësimit në kohë dhe me rregullsi të dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj.

Në rastet kur Veprimet juridike kryhen nga Administratori i emëruar nga Ortakët e vetëm ose personi që Përfaqëson Ortakun e vetëm më 30 ditë të bazeve të Prokurës, këta janë të detyruar që në përfundim të realizimit të veprimit përkatës të njoftojnë menjëherë dhe t'i japin llogari Ortakeve të vetëm.

3. Administratori ose Përfaqësuesi me Prokurë i ortakut të vetëm, janë individualisht përgjegjës ndaj Shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë Statut dhe për demin e shkaktuar me FAJ, sipas rastit, Ortaku vetëm mund të ngrej Padi Civile dhe të kërkojë ndaj tyre shlyerjen e plotë të dimit të shkaktuar, përfshirë dhe fitimin e munguar, duke patur njëkohësisht dhe të drejtën për të bërë kallxim për ndjekje penale në Prokurorin e juridiksionit tokësor përkatës.

NENI 17

Përfaqësimi i Shoqërisë, në mardhëniet me të tretet si brenda vendit dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithësisht i përket Ortakeve të vetëm themelues.



NENI 18

Ortaket e vetem dhe Administratori Shoqerise, i emeruar prej tyre, kane te drejte qe per nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te Shoqerise, te marri ne pune specialiste dhe shtetas te ndryshem madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, duke lidhur Kontraten sipas kriterave qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi, te miratuar me Ligjin Nr.7961 dt.12.07.1995 dhe shtetas e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin "Per Sigurimet Shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disiplines profesionale te caktuara nga ana e punedhenesit.

NENI 19

Administratori Pergjithshem i Shoqerise, caktohet: **Z. Ardian ÇIÇEKU**, atesia Shaban, amesia Myzejen, i datelindjes 19/05/1969, shtetas shqiptar, lindur ne Durres dhe banues ne L.17, Rr."Prof. Halil Myrto" Durres, i cili qendron ne kete detyre per nje periudhe-kohe **5 vjet**, duke filluar ky afat nga data e nenshkrimit te ketij Statuti, me te drejte ripерteritje.

KREU IV:

Bilanci, te ardhurat dhe Shperndarja e Shoqerise.

NENI 20

Veprimet ekonomiko financiare te Shoqerise, mbyllen me daten **31 Dhjetor** te çdo viti.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, behet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda 6 muajeve nga data e mbylljes se vitit financiar.

Per nxjerrjen e rezultatit Kontabel te Shoqerise, mbi bazen e Aktivit dhe Pasivit nga me vendim te Ortakeve caktohet nje Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Eksperti ka per detyre te kontrolloj dhe verifikoj te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise Ekonomiko tregetare te Shoqerise, si ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollin periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille mbi bazen e **Vendimit** te marre nga Ortaket e vetem te Shoqerise.

Ne perfundim te Kontrollit, Eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatatit perfundimtar te Bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollin periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqes dhe dorezoj ne kohe Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve, i cili eshte Organi i vetem per ti shqyrtuar dhe vendosur miratimin e tij.

NENI 21

Nxjerrja e rezultateve te Bilancit vjetor, duhet bere me saktesi dhe duke respektuar te gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre te sistemit te Tatim Taksave qe jane te detyrueshme per tu zbatuar nga çdo subjekt privat qe ushtron veprimtari tregtare.

Eksperti Kontabel i autorizuar pervec te drejtave, ka dhe keto **detyrime**:



1. Garanton Asamblen e Ortakeve se llogarite vjetore jane te rregullta dhe Bilanci eshte nxjerre me saktesi dhe konform rregullave te Ligjit " Mbi Kontabilitetin".

2. Te pasqyroj me vertetesi rezultatet e operacioneve te vitit te kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare te Shoqerise ne mbylljen e vitit financiar te aktivitetit tregtar te saj.

3. Te verifikoj perputhjet me llogarite vjetore te Informacioneve te dhena nga Administratori Shoqerise ne Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve, duke perfshire dhe dokumentat per gjendjen financiare qe ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblese Ortakeve.

4. T'i beje te njohur Ortakeve dhe Administratorit te Shoqerise: Kontrolltet dhe verifikimet qe jane bere prej tij per kontrole periodike ose vjetore, duke vene ne dukje parregullsitet apo pasakesitet e konstatuar, masat ligjore per rregullimin e tyre etj.

5. Eksperti Kontabel i autorizuar eshte pergjegjes ndaj Shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat e demeshme te shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar te Shoqerise, por nuk eshte pergjegjes kur keto DEME shkaktohen pa dijenin e tij dhe nga veprimet me faj te Administratorit te Shoqerise.

NENI 22

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e Vendimit me shkrim te marre nga Ortaket e vetem ne Mbledhjen e Asamblese, ne te cilen jo vetem qe dokumentohet aprovimin e tij por dhe qe percakton dhe ne lidhje me disponibilitetin e Fondeve ligjore, sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te aktivitetit te Shoqerise por dhe per Garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke patur parasysh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

Per Formimin e fondit rezerve, qe emertohet "**Rezerve e domosdoshme**" Ortaket vendosin qe nga fitimi i akumuluar gjate vitit financiar, pasi te zbriten humbjet e vitit te meparshem, te lere te pakten $\frac{1}{20}$ e vleres se fitimit te realizuar.

NENI 23

Te Ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj te treteve, i kalojne ne pronesi Ortakeve te vetem themelues.

NENI 24

Shperndarja ose Prishja e Shoqerise, mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar Shoqeria siç mund te jene:

- a. Humbja e Kapitalit ose pamundesia e vazhdimet te metejshem te veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga Ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".
- c. Me kerkesen e Ortakeve Themelues.

Ne kete rast Ortaket marrin Vendim me shkrim ne te cilin parashikon dhe menyren e Likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe leshuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e Likuidatorit.

NENI 25

Akti i Emerimit te Likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon Ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

NENI 26

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vemendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilave Shoqëria është Kreditore dhe për ekzekutimin e plotë të detyrimeve (debive) që Shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizike ose juridik vendas apo të huaj.

NENI 27

Cdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë mes të tremeve, si rregull dhe pergjithesisht duhet të zgjidhet në mirekuptim në të kundërtën çështjen mund ta bëjnë objekt konflikti gjyqësor, duke ngritur padi në **Gjykatën e rrethit Durrës** ose deri në **Gjykatën nderkombetare të Arbitrazhit**.

NENI 28

Përsa nuk është shprehur në këtë Statut i referohet udhëzimeve plotësuese e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dhëna nga Ortaket e vetëm themelues së Shoqërisë si dhe hapësirave juridike lejuese të Legjislacionit në fuqi dhe normave nderkombetare.

NENI 29

Ky **STATUT** u redaktua në 4 ekzemplare në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga në Ortaket e vetëm Themelues së Shoqërisë tregetare “ **A & S KOMPANI** ” Shpk Durrës – Shqiperi, nënshkruhet në të gjitha ekzemplaret duke u vënë emri, mbiemri dhe firma origjinale, autenticieti i të cilave vërtetohet dhe nga Ortaket.

ORTAKET e VETEM THEMELUES se SHOQERISE

“ **A & S KOMPANI** ” Shpk Durrës – Shqiperi

Miratuesit e këtij Statuti

Z.Ardian ÇICEKU

